



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DELVINË
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Delvinë, më _____._____. 2025

PROCESVERBAL - Tipi i kontratës - PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMINE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT:

REHABILITIMI I KANALIT VADITËS SË TRUSHES VERGO-DELVINË (PJESA E DYTË)

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Punime ndërtimi për kanale ujitëse 45247111-1

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **31,745,948** (tridhjetë e një milionë e shtatëqindë e dyzetë e pesë mijë e nëntëqindë e dyzetë e tetë) **Lekë, pa TVSH.**

Ky objekt financohet nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 392, datë 10.07.2025 Për një ndryshim në Vendimin Nr. 226, datë 09.04.2024 të Këshillit të Ministrave “Për shpërndarjen dhe detajimin e fondit për financimin e projekteve të bashkive nga programi Menaxhimi i Infrastrukturës së Kullimit dhe Ujitjes” i ndryshuar, si dhe shkresën Nr. 5153/4, datë 06.08.2025, protokolluar pranë nesh me Nr. 2037 Prot, datë 08.08.2025 me objekt: Mbi çeljen e fondit për shpenzime kapitale për vitin 2025 të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe e Shërbimeve Mbështetëse).

Argumentimi: Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës është bërë duke iu referuar preventivit të hartuar për këtë objekt, në zbatim të nenit 76 “Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit, pika “1”, gërma “a”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor Bashkia Delvinë (Njësia e Prokurimit) ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë vijon:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të

fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 8.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme përvërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkm, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Kriteret e përgjithshme përmbajne listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, Nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vendosur të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit Nr. 10 datë 23.09.2024 të miratuar nga APP.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi:

Kriteri (1-a) bazohet në nenet 76, 77 dhe 82 të LPP-së si dhe nenit 26 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri (1-b) është vendosur në bazë të nenit 83 të LPP-së dhe nenit 30 pika 1 të VKM-së Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Sipas kriterëve të përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit, (Shtojca 7).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit nga ana e Operatorit Ekonomik sipas Shtojcës 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesi vërtetim xhiroje vjetore të lëshuar nga Administrata Tatimore për 3 (tre) vitet e fundit financiare (përkatësisht vitet 2022, 2023 dhe 2024), ku vlera e xhiros vjetore për periudhën e kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e kontratës. *Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur edhe në qoftë se operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar më lart nga autoriteti kontraktor.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP-së, si dhe nenin 43, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023, 2024 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. *Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe në nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar, mbi bazën e të cilave, AK mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i'u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 5, datë 30.01.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Referuar nenit 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit Nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesi vërtetim për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2024 dhe vitin 2025 (Këstet e Maturuara), për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë (BOE), çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB-së

(Kriteri 2.2.3 do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit; dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme, të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, si më poshtë vijon:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose

b) Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit e kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cili prej tyre do të përmbushë këtë kusht. Kurse pika 2.3.1b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a)** Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9;
 - Kontratë punimesh;
 - Situacionin përfundimtar;

- Aktin e kolaudimit;
- Çertifikatën e marrjes në dorëzim të punimeve të kryera

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Vërtetim lëshuar nga subjekti privat shoqëruar me:
- Kontratë punimesh;
- Situacionin përfundimtar;
- Aktin e kolaudimit;
- Çertifikatën e marrjes në dorëzim të punimeve të kryera;
- Fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore

Për kontratat e realizuara si bashkim operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me preventivin e ndarjes së punimeve që ka marrë përsipër të kryejë secili operator ekonomik në fazën e tenderimit.

Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50% të vlerës së fondit limit për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të objektit të prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me *Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*, i ndryshuar. Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër.

Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

- **N.P - 1 A** Punime gjurmimi në tokë.
- **N.P - 7 B** Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje.

- **N.P. 12 A** Punime të inxhinierisë së mjedisit.

Për punimet speciale të ndërtimit:

- **N.S - 8 A** Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri
- **N.S - 18 A** Punime topogjeodezike

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësimin e licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë licencat profesionale sipas zërave të preventivit që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit merr përsipër të realizojë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

Pikat e licencave janë përcaktuar në bazë të zërave të përshkruar në preventivin e projektit

Niveli i shoqërisë sipas vlerave në lekë të punimeve të kryera për çdo kategori punimi.

<i>Kategoria e kërkuar</i>	<i>Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës</i>	<i>Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</i>	<i>Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive</i>	<i>Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse</i>
NP-1	Punime gjurmimi në tokë.	Punime gjurmimi dheu me eskavator dhe krahë, mbushje, rafshim ngjeshje dheu.	A	0-20 milion
NP-7	Ujësjiellës, gazsjellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje	Rehabilitim i rrjetit shpërndarës të vaditjes deri tek përdoruesi. Punime për kanalizimet e jashtme (puseta shkarkimi)	B	0-20 milion
NP-12	Punime të inxhinierisë së mjedisit.	Punimet për rehabilitimin e kanalit vaditës konsiderohet një vepër e cila është e shpërndarë në territor dhe lind nevoja për procesin e riaftësisimit natyror në gjithë gjatësinë e tij dhe zonën përreth tij.	A	0-20 milion

NS-8	<i>Ndërtimë parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri</i>	<i>Prodhimë në rrugë industriale dhe montimi në vepër i strukturave prej betoni (tombino me tuba betoni) si dhe konstruksioni të thjeshta metalike sipas preventivit.</i>	A	0-20 milion
NS-18	<i>Punime topogjeodezike.</i>	<i>Punimet topogjeodezike për rehabilitimin dhe pozicionimin e veprës (GPS) dhe sistemit të terreneve të tjera të jashtme që paraqesin nevojën e punimeve të tilla</i>	A	0-20 milion

2.3.3 Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklarate (nga Administratori i Shoqërisë), Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën dhe listpagesat e shoqërisë, dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt dhe për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kontratë pune
- b) Diplomë

(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varësi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së bashkëpunimit)

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit; dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar si dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe në UKM Nr. 2 datë 13.05.2005, Kreu I, pika 2, “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, i cili përcakton se Për projekte me vlerë të plotë të preventuar mbi 30,000,000 lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë të plotë në objekt, i diplomuar në inxhinieri ndërtimi. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

2.3.4 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të cilët duhet të figurojnë në licencën si dhe listëpagesat e shoqërisë për periudhën Qershor 2025 - Gusht 2025, si mëposhtë:

- | | |
|-------------------------|---------|
| - Inxhinier Ndërtimi | 1(një). |
| - Inxhinier Hidroteknik | 1(një). |
| - Inxhinier Mjedisi | 1(një). |
| - Inxhinier Gjeodet | 1(një). |
| - Inxhinier Gjeolog | 1(një). |

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës noteriale e vlefshme dhe diploma Drejtuesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM-së Nr. 42 datë 16.01.2008, i ndryshuar, sa i takon ndalimeve të dypunësimit.

Për këtë arsye të paraqitet deklaratë përkatëse nga Administratori i Shoqërisë

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit; dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf dhe punonjës të kualifikuar, si më poshtë:

- 2 (dy) Punonjës teknik ndërtimi.
- 1 (një) Punonjës teknik topograf.
- 2 (dy) Karpentier
- 2 (dy) Hekurkthyes
- 2 (dy) Betonues
- 1 (një) Punonjës për Konstrukione Metalike

- 2 (dy) Saldator
 - 1 (një) Mekanik
 - 4 (katër) Shofer
 - 2 (dy) Manovrator
- Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për për 3 muajt e fundit.
 - Për punonjësit e kualifikuar të ndërtimit të paraqitet Certifikatat/diplomat/dëshmia të lëshuara nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.SH” i ndryshuar.
 - Për teknikët e ndërtimit dhe teknikun topograf do të pranohet vetëm diploma e shkollës së mesme/licencë profesionale nga institucionet përkatëse.
 - Për Shoferët të paraqitet Leja e Drejtimit dhe CAP
 - Për Manovratorët të paraqitet DAP
 - Për profesionet si me sipër, operatori ekonomik duhet të plotësoj tabelën si më poshtë:

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni i punonjësit	Emri i Institucionit publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Numri identifikues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT - (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1					
2					
.....					

- Nuk do të njihen si dëshmi profesionale kurset e trajnimit të lëshuara nga subjektet të cilat nuk janë të licencuara/akredituara nga institucionet përkatëse për licencimin/akreditimin e tyre.
- Në rast se operatori ekonomik i disponon mjetet e rënda në pronësi, manovratorët duhet të jenë në listëpagesën e shoqërisë për periudhën Qershor 2025 - Gusht 2025.
- Për mjetet e rënda të cilat janë të marra me qera, OE duhet të paraqesë për manovratorin, kontratën e punës së vlefshme, dëshminë e drejtimit të vlefshme, lëshuar nga institucionet përkatëse, dëshmitë e drejtimit të lëshuara nga DPSHTRR, por pa qenë e nevojshme që këta manovratorë të figurojnë në listëpagesën e OE.

Shënim: Në rastin kur makineritë disponohen me qera disponimi i drejtuesve për këto mjete nga ana e operatorit ekonomik mund të rregullohet edhe nëpërmjet mënyrës së kontraktimit të tyre.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit; dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori

ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për punonjesit e kualifikuar lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve, duke krijuar besueshmërinë se kanë përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Punonjësi teknik ndërtimi** është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Punonjës teknik topograf** është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Karpentierët** janë të nevojshëm për prerjen dhe montimin e strukturave prej druri e metali si dhe ndërtimin e kornizave dhe strukturave të tjera përforcuese prej druri, bashkimin dhe montimin e elementeve metalik apo materiale të tjera, të nevojshme për realizimin e punimeve në objektit.
- **Hekurkthyesi** është i nevojshëm për përzgjedhjen, prerjen, kthimin dhe vendosjen e hekurit, për realizimin zërave të preventivit të punimeve.
- **Betonues** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të betonit, sipas zërave të preventivit.
- **Punonjës për Konstrukione Metalike** është i nevojshëm për realizimin e punimeve kostrukione metalike, sipas zërave të preventivit
- **Saldator**, është i nevojshëm për realizimin e punimeve të saldimit në vepër
- **Mekanik** është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndryshme me natyrë mekanike, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Shofer** është i nevojshëm për drejtimin e mjeteve si kamione, kamionçina etj.
- **Manovratori është i nevojshëm për** përdorimin e mjeteve të rënda si eskavator, fadrome etj. si dhe bazuar në rregulloren “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me Urdhërin Nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit për 3 (tre) muaj.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është bazuar në ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenin 39, pika 3 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2.3.7 Operatori/ët ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar si:

- 1 (një) punonjës me certifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr.10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe VKM-në Nr.312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, diplome/certifikatë.
- 1 (një) punonjës i pajisur me certifikatë "Përgjegjës për dëmet në mjedis" gjatë kryerjes së veprimtarisë, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", (I ndryshuar)

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën Qershor 2025 - Gusht 2025

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit; dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Konkretisht: Këto kriterë janë vendosur në mbështetje të Ligjit 10237, datë 18.02.2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" si dhe të VKM Nr.312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier". Njësia e prokurimit gjykon se për mbarrëvajtjen e punimeve, me qëllim garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident si dhe në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni sektorial në fuqi, është e nevojshme prezenca e ekspertit për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në kantierin e punimeve. Përsa i përket punonjësit përgjegjës për dëmet në mjedis sqarojmë se kriteri është vendosur në përputhje të plotë me klauzolat e Ligjit Nr 10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit" me qëllim marrjen e masave parandaluese dhe rehabilituese për mbrojtjen e mjedisit.

Autoriteti kontraktor duke vlerësuar të gjitha detyrat që mbulojnë këta punonjës për sigurinë në kantier, mbrojtjen e mjedisit, garantimin e një produkti final eficient në drejtim të energjisë ka gjykuar të jenë staf mbështetës pasi duhet të kryejë funksione të tilla të rëndësishme në kantier si mirëmbajtjen e kontrollin para fillimit të punës dhe kontrollin periodik të impianteve dhe pajisjeve të punës me qëllim eliminimin e defekteve që mund të dëmtojnë sigurinë ose shëndetin

e punëmarrësve; caktojnë kufijtë dhe përgatitin zonën e stoqeve dhe të depozitimit të materialeve, në veçanti kur bëhet fjalë për lëndë dhe substanca të rrezikshme; përshtatin në funksion të zhvillimit të kantierit, të kohëzgjatjes efektive që duhet t'i jepet llojeve të ndryshme të punës ose fazave të punës; kryejnë bashkëpunimin midis punëdhënësve dhe punëmarrësve të pavarur; kryejnë bashkëveprimin me aktivitetet që ndodhin në vendndodhje, brenda dhe në afërsi të kantierit. Operatori ekonomik duke angazhuar punonjës të kualifikuar dhe me eksperiencë, vlerëson rëndësinë e projektit në fjalë rrit performancën e realizimit të projektit, rrit vlerën e investimit njerëzor në projekt, dhe në këtë mënyrë siguron suksesin e përbashkët.

2.3.8 Operatori/et ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me licencë nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim, ruajtje dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme” ose të ketë kontratë shërbimi noteriale për objektin konkret me shoqëri të licensuara. Mbështetur në: Ligjin Nr. 9010, datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta” (Ndryshuar me Ligjin Nr.10137, datë 11.05.2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”) Licenca duhet të shoqërohet me akt miratimin.

Argumentimi: Kriteri për licencën e lëshuar nga QKL me kodin III. 2. B është vendosur që AK të ketë sigurinë që operatori ekonomik që do të ofertoj të jetë i pajisur me certifikatat e mësipërme ose të ketë kontratë shërbimi me subjekte të licencuara me licencën e lartpërmendur, të lidhura me objektin e prokurimit, gjë e cila krijon bindjen dhe sigurinë te Autoriteti Kontraktor që ky Operator Ekonomik i zotëron kapacitetet teknike për realizimin me sukses të kontratës. Në seksionin “Kategoria III.2. “Shërbime Ekspertizë ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis”, nënseksioni “Licencimi i kategorisë III.2.B”, pika 8 dhe 9 të Vendimit Nr. 538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licensimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar, parashikohet se: “Licencat për nënkategorinë III.2.B jepet për çdo vend ku kryhet veprimtaria. 9. Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme.” Për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik e konkretisht licencë profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, ku të përfshihen ndër të tjera edhe transporti i mbetjeve të ngurta, gjatë kryerjes së veprimtarisë ose të kenë këtë kontratë shërbimi noteriale për objektin konkret me shoqëri të licencuara si më sipër. Në nenin 5 të ligjit nr.10081 datë 23.02.2009 “Për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se “Ushtrimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë, si rregull, të lira dhe nuk i nënshtrohen licencimit apo autorizimit, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj” Sa më sipër konstatohet se gjatë kryerjes së punimeve, referuar edhe parashikimeve të preventivit, shfaqet ndër të tjera kryerja e veprimtarisë transporti i mbetjeve inerte i cili referuar kuadrin ligjor në fuqi duhet të kryhet nga subjekte të licencuara dhe është në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës. Kërkesa për të paraqitur akt miratimin është bërë për të verifikuar nëse mbetjet që do të largohen janë të përcaktuara në licencën e subjektit për tu administruar dhe transportuar.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat ISO si më poshtë:

- a) Certifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 ose Ekuivalente (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtar Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO 9001:2015).
- b) Çertifikatën e menaxhimit të mjedisit ISO 14001-2015 ose Ekuivalente (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtar Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO 14001-2015.
- c) Certifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2018/45001-2023, ose Ekuivalente (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtar Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO 45001-2018/45001-2023.
- d) Certifikatën e menaxhimit të energjisë ISO 50001-2018 ose Ekuivalente (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtar Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatori ekonomik që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit do të marrë përsipër realizimin e zërave elektrikë të Preventivit duhet të paraqesë Certifikatën ISO.
- e) Certifikatën e menaxhimit të cilësisë në Saldim EN-ISO 3834-2:2021 ose Ekuivalente (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtar Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën EN-ISO 3834-2:2021.
- f) Çertifikatën e cilësisë sipas standartit SSH BS PAS 99:2012 ose Ekuivalent të tij (Sistemi i menaxhimit të integruar, e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtar Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik duhet të plotësohet nga secili prej anëtarëve në varësi të natyrës të zërave të punës të marra përsipër sipas Akt Marrëveshjes së Bashkimit.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*. AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara sipas pikës 14 gërma është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion të cilat janë si më poshtë vijon:

Nr	Mjete/pajisje teknike	Statusi	Njësia	Sasia
1	Automjet vetëshkarkues me masë maksimale të autorizuar 7.5-18 ton	Pronësi/Qera	copë	2
2	Automjet vetëshkarkues me masë maksimale të autorizuar mbi 18 ton	Pronësi/Qera	copë	2
3	Eskavator (Mjet Teknologjik me Goma)	Pronësi/Qera	copë	3
4	Minieskavator (Mjet Teknologjik me Goma)	Pronësi/Qera	copë	1
5	Fadromë (Mjet Teknologjik me Goma)	Pronësi/Qera	copë	3
6	Mini Fadromë me goma (Mjet Teknologjik me Goma)	Pronësi/Qera	copë	2
7	Minidamper (Mjet Teknologjik me Goma)	Pronësi/Qera	copë	2
8	Autobetoniere	Pronësi/Qera	copë	2
9	Autopompë Betoni	Pronësi/Qera	copë	1
10	Kamionçinë me kapacitet mbajtës 3.5-5 Ton	Pronësi/Qera	copë	2
11	Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 1.5 Ton	Pronësi/Qera	copë	2
12	Aparat topogjeodezik me GPS	Pronësi/Qera	copë	1
13	Autobot uji	Pronësi/Qera	copë	2
14	Kamion vinç	Pronësi/Qera	copë	2
15	Badibald/Kompator	Pronësi/Qera	copë	1
16	Elektrosaldatriçe	Pronësi/Qera	copë	2
17	Gjeneratorë	Pronësi/Qera	copë	1
18	Autobetoniere me kapacitet 2.5-3.5 m ³ (mjet teknologjik)	Pronësi/Qera	copë	1
19	Tranxh Hekuri	Pronësi/Qera	copë	1

20	Rul hekur-gomë me kapacitet mbi 18 ton	Pronësi/Qera	copë	1
21	Eskavator me xhinxhir me çekiç	Pronësi/Qera	copë	1
22	Rimorkio mbi 20 ton për transportimin e mjeteve të rënda	Pronësi/Qera	copë	1
23	Gjenerator mbi 50 kva	Pronësi/Qera	copë	1
24	Gazogjen/Aparat Gazogjen	Pronësi/Qera	copë	2
25	Vibrator betoni	Pronësi/Qera	copë	4

- a. Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit: (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) certifikatë e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
- b. Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) certifikatën e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
- c. Për mjetet e deklaruar që transportojnë mallra të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqitet certifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet përkatëse (e vlefshme).
- d. Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes ose fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes ose kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit; dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Mjetet dhe pajisjet e kërkuara

janë vendosur në proporcion me zërat dhe volumet e punimeve dhe afatin e përlllogaritur për realizimin e kontratës objekt prokurimi.

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi/qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i'u referuar punimeve sipas standardeve, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve (3 Muaj) dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

2.3.11 Operatorët ekonomik duhet të kenë në pronësi/kontratë qeraje/kontratë furnizimi 1 (një) fabrikë betoni, e cila duhet të jetë e pajisur me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B, për të cilën duhet të paraqesin dokumentacionin e pronësisë/kontratën e qerasë/kontratën e furnizimit shoqëruar me leje mjedisore QKL Kodi III.1.B.

Për linjën e prodhimit të betonit operatori ekonomik duhet të paraqesë Raport vetëmonitorimi, Planvendosjen si dhe Çertifikatën e Kalibrimit

Shënim: Në rastin kur Fabrika e betonit do të jetë me Kontratë Furnizimi paraqitja e lejes mjedisore dhe dokumentave të tjerë të fabrikës nuk janë kusht, por duhet të paraqitet kontrata e furnizimit me subjektin përkatës (e vlefshme)

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit; dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Kriteri është vendosur referuar zërave të punimeve për produktin beton, shtresa betoni etj.

2.3.12 Operatorët ekonomik duhet të kenë 1 (një) Gurore për shfrytëzimin e llojit mineral gëlqeror, pllakor që bën pjesë në llojin e mineraleve ndërtimore (inert), e cila duhet të jetë e pajisur me dokument pronësie dhe leje IV.1.B.2, shoqëruar me akt miratimet e lejeve lëshuar nga autoritetet e autorizuar me ligj.

Në rastin kur operatorët ekonomik kanë kontratë qiraje apo kontratë furnizimi me prodhuesin duhet të paraqitet kontrata e qirasë (e vlefshme) apo kontrata e furnizimit (e vlefshme)

Shënim: Në rastin kur Gurorja do të jetë me Kontratë Furnizimi paraqitja e lejes dhe dokumentave të tjerë të saj nuk janë kusht, por duhet të paraqitet kontrata e furnizimit me subjektin përkatës (e vlefshme)

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit; dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Kriteri është vendosur referuar zërave të punimeve për produktet rërë natyrore (inert), gurë etj.

2.3.13 Në përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivin përkatës të publikuar në SPE, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/kontratë bashkëpunimi/furnizimi nga prodhuesi/distributori, për produktin Hekur.

Në rast paraqitjeje të autorizimit nga Distributori duhet të paraqitet dokumentacioni që vërteton lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit të autorizuar.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Vendosja e këtij kriteri, referuar legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë sipas projektit të zbatimit të hartuar nga projektuesi dhe marrë në dorëzim nga grupi i punës përkatës për marrjen në dorëzim të projektit me dokumentacionin teknik të tij, duke iu përmbajtur parashikimeve të nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Shënim: Në të gjitha rastet në specifikime teknike ose preventiv ku mund të jenë përmendur markë specifike apo emërtim AK ka parashikuar se do të pranohen edhe ekuivalentët e tyre.

Shënim: Në të gjitha rastet ku në Dokumentat e Tenderit, specifikimet teknike ose preventiv përmenden standarte ndërkombëtare AK, ka parashikuar se do të pranohen edhe standartet kombëtare të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri.

Në Specifikimet Teknike (Bashkëlidhur në SPE) Autoriteti Kontraktor i është referuar standarteve europiane/ndërkombëtare si: EN 206-1 :2000, ENV 13670-1 :2000, BS 8110, BS 8007, EN 197-1 :2000, EN 12620, EN 1097-3 :1998.... si dhe standarteve të tjera europiane

Nisur nga fakti që ekzistojnë standarte ndërkombëtare të adoptuara në ato kombëtare nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe mundësinë e paraqitjes së standartit SSH/UNI/EN, mbi konformitetin e standartit europian, të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Komisioni unanimisht bëri miratimin e këtyre kritereve për kualifikim dhe vendosi vazhdimin e mëtejshëm i procedurave në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE).

NJËSIA E PROKURIMIT

1. _____
(Emri, Mbiemri, Firma)

2. _____
(Emri, Mbiemri, Firma)

3. _____
(Emri, Mbiemri, Firma)